



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.404/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Subjektit, Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 09.02.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohet e pazuar ankesa Anr.404/2025 e datës 06.02.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Subjektit Politik. Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë 06.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesë nga subjekti politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se subjekti politik, LDK-Dega në Prishtinë, ka vërejtur se subjekti politik LVV me rastin e vendosjes së banerit dhe posterit të kandidatit për deputet, Albin Kurti, në Sheshin "Nënë Terezë", në rrugën "Rexhep Luci" në mënyrë të kundërligjshme pa lejen e organit kompetent të komunës, duke bërë shkelje të nenit 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të LZP, i cili shprehimisht thotë: *"vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve.* Andaj, duke u bazuar në gjithë këto ka kërkuar që të shqiptohet mase sanksionuese ndaj subjektit politik LVV, rast i precedent dhe identik është vendimi dënues i PZAP-së A.nr.174/2025. Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografi.

Më datë 07.02.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri më 07.02.2025 në ora 19.00.

Në përgjigje në ankesë Subjekti Politik LVV thekson se pretendimet e tilla në ankesë, janë të pabaza dhe të paqëndrueshme, kjo për faktin se të njëjtat nuk përmbajnë ndonjë fakt dhe provë e cila do të binte ndesh me nenin 34 të LZP-së, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 si dhe me Rregulloren Zgjedhore 07/2024. Për shfrytëzimin e hapësirës së tillë në Rrugën "Rexhep Luci", Lëvizja Vetëvendosje posedon leje/pëlqim e cila konfirmohet në Njoftimin e datës 29 janar 2025 nga Drejtoria Komunale për Shërbime. Në njoftimin e tillë, Drejtoria Komunale për Shërbime njofton se bazuar në legjislacionin përkatës, Drejtoria nuk lëshon pëlqime për pronën private. Tutje në Njoftim, Drejtoria Komunale për Shërbime konfirmon se pëlqimet për shfrytëzimin e hapësirës së tillë reklamuese, janë lëshuar nga pronarët. Më tutje në përgjigje në ankesë ka theksuar se për raste të natyrës së njëjtë, PZAP tashmë ka vendosur praktikë përmes vendimit numër Anr.79/2025, në të cilin vendim, konfirmon se për rastet e natyrës së tillë, përveç lejes së pronarëve privat, duhet gjithashtu leje/konfirmim edhe nga Drejtoria Komunale për Shërbime. Andaj LVV posedon pëlqimin e pronarëve si dhe konfirmimin përmes njoftimit të Drejtorisë Komunale për Shërbime për shfrytëzimin e hapësirës së tillë për reklamimin e materialeve zgjedhore. Si provë ka bashkangjitur njoftimin e Drejtorisë Komunale për Shërbime, Komuna e Prishtinës dhe Pëlqimet e pronarëve.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën, përgjigjen në ankesë, vëren se ankesa është e pa bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik LVV, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LDK, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve.”*

Kjo për faktin se parashtruesi i ankesës i referohet shkeljes së dispozitës ligjore të lartcekur, mirëpo paneli në bazë të shkresave të bashkangjitura në përgjigje në ankesë në këtë rast, Njoftimin e lëshuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike të Komunës së Prishtinës, mbi shfrytëzimin e hapësirës reklamuese për aktivitete të fushatës, në rrugën “Rexhep Luci”, në të cilin ka theksuar se pëlqimet për shfrytëzimin e hapësirës reklamuese janë lëshuar nga pronarët, e të cilët ia ka bashkangjitur përgjigjes në ankesë pëlqime këto të datës 22.01.2025, vërtetoi se baneri/posteri i vendosur nga kandidati i Subjekti Politik LVV, është në pajtim me nenin 5 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024, për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimit Financiar, neni 5 që i normon të drejtat dhe obligimet e subjekteve politike gjatë mbajtjes së tubimeve publike konkretisht, nën paragrafi

1.2 “të publikojnë dhe të shpërndajnë afishe përmes shtandëve apo në hapësira publike, reklama dhe material tjetër lidhur me një fushatë zgjedhore”.

Prandaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtuesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.404/2025, datë 09.02.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.